Institucioni Drejtoria e Pergjithshme e mirembajtjes se objekteve publike.		3,218,829
Institucioni Ndermarrja e Pergjithshme e Puneve publike		1,400,788
Institucioni Drejtoria MZSH		706,179
Institucioni Institucioni Shtepia e Foshnjes		318,542
Institucioni Institucioni Shtepia e Femijes shkollor		495,288
Institucioni Institucioni Qendra e Zhvillimit		<b>828,866</b>

ni

		<b>20,132,071</b>
<b>Ne llogarine 436 "Sigurime shendetesore" shuma prej 2,750,669lek</b>		
	Bashkia Administrata + Njesite Administrative	1,835,695
Institucioni	Ndermarrja e Pergjithshme e Puneve publike	158,752
Institucioni	Drejtoria e Pergjithshme e mirembajtjes se objekteve publike.	448,066
Institucioni	Drejtoria MZSH	80,034
Institucioni	Institucioni Shtepia e Foshnjes	44,207
Institucioni	Institucioni Shtepia e Femijes shkollor	68,734
Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	115,181
		<b>2,750,669</b>
<b>Ne llogarine 467 "Kreditore te Ndryshem "me nje saldo kreditore prej 50,805,102 leke perfshihen :</b>		
	Bashkia + NJA	<b>50,708,993</b>
	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	
	Qendra Zhvillimit	37,143
	Shtepia e Foshnjes	58,966
	Shtepia e Femijes Shkollor	
	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	
		<b>50,805,102</b>
<b>Ne llogarine 466 "Kreditore per mjete ne ruajtje" me nje saldo kreditore prej 122,213,306 leke perfshihen :</b>		
	Bashkia + NJA	103,333,671
	Dega Ekonomike e Kultures	
	Drejtoria Kopshte Çerdhe	
	Ndermarrja e Pergjithshme e Puneve publike	4,613,090
	Drejtori e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore.	
	Drejtoria e Pergjithshme e mirembajtjes se objekteve publike.	14,266,545
		<b>122,213,306</b>
<b>Ne llogarine 470 Llogari ne pritje - Te ardhura per tu marre 1,630,459,964leke perfshihen :</b>		

Te ardhura te regjistruara ne llogarine debitore te ndryshem Bashkia  
1,630,459,964

Ne llogarine 26 Pjesmarrje ne kapitalin e vet me vlerë 1,105,528,039 perfshihen :

Shoqerite	Pjesmarrja e Aksioneve	Vlera e kapitalit bashkise Shkoder
Tregu i Shitjes me Shumice Fruta – Perime	100 % të aksioneve	78,885,878
Ujësjetllës Shkoder	100 % aksione	863,468,000
Parku i Udhëtarëve Shkodër	60 % të aksioneve	13,944,000
Shoqeria Rajonale e Ujësjetllës –Kanalizime Shkoder	36% e aksioneve	14,053,000
Ndermarrja SKODRINON	100 % aksione	5,876,833
Nd/ja trajtimet te Studenteve	100% Aksione	129,300,328

## II. NXJERRJA JASHTË PËRDORIMI TË AKTIVEVE.

Për vitin 2025 ka patur procedura të nxjerrjes jashtë përdorimi te cilat i përkasin perfundimit te procedurës së nxjerrjes jashte përdorimi në proces nga viti 2024.

Në zbatim të Urdhërit nr.1768 datë 10.12.2024 “Për inventarizimin e Inventarit Ekonomik, Paisjeve Energjitike, Inventarit të Imët dhe Mjeteve të Transportit në përdorim të punonjësve të Bashkisë Qendër dhe Njësive Administrative” dhe urdherit nr 1769 date 10.12.2024 per inventarizimin e Magazinave, u be inventarizimi i tyre dhe komisioni doli me nje liste artikujsh jashte funksioni.

Me shkresën nr 117/b datë 13.01.2025 komisioni i inventarizimit informon Kryetarin e Bashkisë për kryerjen e procedurës së inventarizimit dhe dërgon listën e materialeve që janë jashte funksioni.

Kryetari i Bashkisë nxjerr urdherin nr 54 date 16.01.2025” Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të materialeve të Bashkisë Shkodër të identifikuar si jashte funksioni, nga komisioni i inventarizimit.

Grupi i vlerësimit të inventarit dërgon tek Kryetari i Bashkse me shkresë nr 210/b date 21.01.2025 relacionin dhe proces verbalin e vleresimit .

Kryetari i Bashkisë pas marrjes se informacionit nxjerr urdherin nr 96 datë 30.01.2025 per Ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashte perdorimi të aktiveve te vleresuar si jashte funksioni”.

Komisioni i nxjerrjes se aktiveve jashtë përdorimi me shkresë nr 880/b datë 28.02.2025 dërgon tek Kryetari i Bashkisë relacionin duke i propozuar Kryetarit të Bashkisë listën e aktiveve qe do të asgjësohen në Landfill materialet me vlere 11,532,918.36 leke, listen e paisjeve informatike dhe elektronike ,te cilat do te asgjesohen me kompani te treta sipas legjislacionit ne fuqi me vlere 18,622,646,gjithashtu listen e materialeve qe kane perberje metalike qe asgjesohen me ane te procedures se ankandit publik te hapur per scrap me vlere 8,327,639 leke paisje te cilat ndodhen ne magazinat e Bashkise Shkoder, 1,617,000 leke kazerat me vendodhje ne Njesine Administrative Guri i Zi si dhe automjeteve te cilat do te shiteshin me procedure ankandi per skrap me vlere 150.000 leke. Komisioni beri dhe peshimin e materialeve te hekurit qe ndodhej ne magazine,te cilat rezultuan me nje peshe 6,920 kg sipas fleteve peshoreve. Pesha totale e te gjithë materialeve te ndodhuar ne magazine si dhe konteniereve e makinave rezultoi 30,735 kg. Gjithashtu komisioni vendosi te nxjerre me procedure shitje ankandi te hapur me cope si automjet ne teresi automjetet me vlere 6,468,000 leke.

Me ane te Vendimit nr.149 dt 10.04.2025 Kryetari i Bashkise Shkoder vendosi “Miratimin e propozimeve te komisionit per nxjerrjen jashte perdorimi te aktiveve te vleresuara si jashte funksioni ne pronesi te Bashkise Shkoder,sipas propozimeve te komisionit te Asgjesimit.

Me ane te relacionit nr.8535 Prot dt 24.04.2025 komisioni raporton procesin e realizuar ku mundesoi shkaterrimin e aktiveve permes ndihmes se punetoreve duke ndryshuar formen fillestare per te bere te mundur asgjesisimin e tyre te plote ne Landfildin e Qytetit me vlere totale 11,532,918.36 dhe peshe totale 7640 kg te ndare instalime 5,373,091 lek , inventar ekonomik 187,280 lek , 5,972,547 inventar qarkullues.

Procedura e nxjerrjes jashte përdorimi është bërë në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Nxjerrja jashte përdorimi dhe asgjësimi është bërë duke zbatuar në menyre rigoroze të gjitha hapat që përcaktohen ne Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar..

Vleresimi i aktiveve është bërë duke pasur parasysh kriteret e vlerësimit të aktiveve si :

plotësimi i kohes së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit

pamundësinë e riparimit si pasojë e konsumit

dëmtimi në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpermjet riparimit

kur vlere e riparimit ose e pershtatjes për t’i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlere e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm

kur kanë humbur cilësinë e tyre të caktuara në standartet shtetërore ose në kushtet teknike

Me vendimin nr 4 datë 26.01.2026 të Këshillit Bashkiak ‘ ‘ Për miratimin e shitjes së mjeteve të transportit, me procedurë ankandi publik, si automjete në tërësi, si dhe të automjeteve dhe materialeve që përmbajnë hekur, per procedurë ankandi publik për skrap’ ’ është miratuar shitja me ankand e cila është në proces realizimi.

### III.DETAJIMI I DETYRIMEVE TË PALIKUIDUARA NË FUND TË VITIT BUXHETOR 2025

Në fund të vitit 2025 kemi një gjendje detyrimesh në shumën prej 234,774,557lekë shumë e cila përbëhet nga :

Llogaria	Emertmi	Bashkia + Institucionet
40	Furnitore e llogari te lidhura me to	80,417,191
42	Personeli e llogari te lidhura me to	73,091,975
431	Shteti tatim-taksa	6,701,336
435	Sigurime shoqerore	20,132,071
436	Sigurime shendetsore	2,750,669
467	Kreditore te ndryshem	50,805,102
4341	Operacione me shtetin( detyrime)	876,213
	<b>Totali</b>	<b>234,774,557</b>

Ju, sqarojmë se sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 35, date 29.12.2023, “Per monitorimin dhe publikimin periodik te stokut te detyrimeve te prapambetura te qeverisjes se pergjithshme”, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 40, germa “h”, detyrimet e Bashkisë Shkodër janë krijuar në vite, si rrjedhojë e keqmenaxhimit të financave nga ish Komunat (Njësitë Administrative), kjo në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial.

Me vendim te Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder”, Bashkia Shkoder, ka trasheguar nga ish-komunat detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata.

Për vitin 2025, Bashkia Shkoder, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresat si vijon :

Me shkresë nr 10616, datë 27.05.2025, me objekt ‘Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Prill 2025 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodër’.

Me shkresë nr 19372 datë 29.09.2025 me objekt ‘Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Gusht 2025 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodër’.

Me shkresë nr 4464 datë 26.02.2026 me objekt ‘Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2025 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodër’.

Bashkia Shkodër nuk ka stok të regjistruar në sistemin informatik të qeverisë.

Sipas ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, janë katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Bashkia Shkodër është bashki që nuk ka detyrime, e ka nivelin e stokut te papërfillshëm dhe është në gjendje shumë të mirë financiare.

Në ligjin nr 68/2017, përcaktohet se “Rastet sipas gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”(Aneksi 1) dhe “Treguesit fiskale te konsoliduar te NJVQV” (Aneksi 2), jane dy tabelat që do raportohen një herë në katër muaj në Ministrinë e Financave, së bashku me raportin e monitorimit.

**Bashkia Shkoder**  
*Në lekë*

<b>Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore</b>				
<b>Situata Normale</b>	<b>Probleme financiare</b>	<b>Vështirësi financiare</b>	<b>Vështirësi serioze financiare</b>	<b>Paaftësi paguese</b>
e gjendjes fiannciar e	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%

Sqarojmë se Bashkia Shkodër ka likuiditete, fonde disponibël, por përse kohë që procedurat janë me mungesë dokumentacioni, si dhe procese gjyqësore të cilat janë në proces, këto procedera nuk mund të rregjistrohen si detyrime të prapambetura, por të gjitha këto detyrime janë të pasqyruara në bilanc.

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM**

### **IV.1. AUDITI I BRENDSHËM**

Funksioni i Auditimit të Brendshëm, si veprimtari e pavarur ndihmon menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke vlerësuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim që të përcaktojë nëse ato funksionojnë në mënyrë efikente për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Gjatë kryerjes së angazhimeve të vitit 2025 Njësia e Auditimit të Brendshëm është mbështetur në Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar nga Kryetar i Bashkisë, shkresa nr. 20436 Prot. datë 18.10.2024, ndryshuar me shkresën nr. 14497 Prot. datë 14.07.2025 “Ndryshimi i planit vjetor 2025, janë ndjekur procedurat standarte të auditimit, bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, Standartet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore për auditimin e brendshëm.

Janë përcaktuar objektiva dhe programe konkrete për realizimin e angazhimeve të auditimit si:

- 🌿 Dhënies përparësi për auditim atyre fushave që janë vlerësuar me risk të lartë dhe të mesëm ;
- 🌿 Përmirësimit të kapaciteteve të audituesve sipas standarteve të reja globale të auditimit të brendshëm dhe manualit të Auditimit të Brendshëm të ndryshuar;
- 🌿 Përmirësimin e programeve dhe metodologjisë së auditimit;

Njësia e Auditimit të Brendshëm në të gjitha subjektet e audituara, ka kryer vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe nga këto vlerësime vërehet se këto sisteme janë ngritur dhe funksionojnë në nivel mesatar.

### **IV.2 . ANALIZA E ANGAZHIMEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.**

Angazhimet e auditimit janë kryer mbështetur në procedurat standarte të përcaktuara në manualin dhe standartet globale të auditimit të brendshëm, duke respektuar të gjitha fazat deri në hartimin e Memorandumit ku në mënyrë të përmbledhur është informuar Kryetar i Bashkisë.

Për periudhën raportuese vitin 2025, janë planifikuar për tu realizuar 10(dhjetë) angazhime auditimi, dhe janë realizuar 9 (nëntë) angazhime auditimi . Plani vjetor 2025 ka pësuar dy ndryshime, me kërkesë të drejtimit është bërë zëvendësim i subjekteve të auditimit, dhe ndërprerje angazhimi të auditimit për të shmangur mbivendosjen e programeve me strukturat e tjera audituese. Sipas gjetjeve janë dhënë gjithsej 116 rekomandime për përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të klasifikuara në ;

- 🌿 Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sistemin e qeverisjes dhe administrimit 48;
- 🌿 Rekomandime në sistemin planifikimi dhe buxhetimi 14;
- 🌿 Rekomandime në sistemin e prokurimeve 22 ;
- 🌿 Rekomandim në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore 1;
- 🌿 Rekomandime në sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitetit 11;
- 🌿 Rekomandime në sistemin e aktiveve të qëndrueshme 4;
- 🌿 Rekomandime në sistemin e të Ardhurave 16

Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm është trajtuar si një proces i pandërprerë dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë veprimtarisë, ku janë pjesë të gjithë strukturat dhe punonjësit e subjektit të audituar.

Vlerësimi është bërë sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si më poshtë:

- 🌿 Mjedisi i kontrollit, integriteti dhe vlerat etike ,struktura organizative linjat e raportimit, përgjegjësitë dhe kompetencat.
- 🌿 Menaxhimi riskut për të gjithë veprimtarinë e subjekteve të audituara, që ndikojnë në arritjen e objektivave dhe analizimin e faktorëve për përcaktimin e mënyrave për menaxhimin e risqeve.
- 🌿 Aktivitetet e kontrollit operacional, vlerësimi i kontroleve në raport me risqet që duhet të minimizohen.
- 🌿 Informacioni dhe Komunikimi ,vlerësimi i sistemit të komunikimit funksionimi në mënyrën e duhur duke përcjellë një informacion cilësor me qëllim përmbushjen e kërkesave dhe specifikat e nevojshme të Menaxhimit.
- 🌿 Monitorimi i veprimtarive dhe proceseve, vlerësimi i krijimit të një sistemi monitorimi efektiv dhe të vazhdueshëm.

#### • **Prioritetet në vazhdimësi :**

Implementimi i standardeve të reja globale dhe kalimi në një qasje të bazuar në risk, zgjerimi i auditimeve të performancës, auditimit të sistemeve IT-së, dhe forcimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë për të garantuar cilësinë e punës audituese.

- 🌿 Sigurimi i një nivel të lartë profesionalizmi nëpërmjet implementimit të standardeve globale të auditimit si dhe praktikave më të mira të auditimit kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 🌿 Rritja e cilësisë së planifikimit dhe kryerjes së angazhimeve të auditimit përmes një analize të detajuar të riskut institucional, rritja e besueshmërisë së punës së NjAB në raport me strukturat e Bashkisë dhe organet mbikëqyrëse.
- 🌿 Forcimi i pavarësisë dhe integritetit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
- 🌿 Dhënia e rekomandimeve konstruktive, cilësore dhe të zbatueshme që të ndihmojnë subjektet në përmirësimin e veprimtarisë, si dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna .

#### **Zbatimi i rekomandimeve**

Për vitin 2025, bazuar në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e punës dhe arritjen e objektivave në subjektet e audituara janë dhënë 116 rekomandime. Subjektet e audituara kanë pranuar të gjitha rekomandimet e lëna nga audituesit për të vijuar zbatimin e tyre në periudhën në vazhdim.

Rekomandimet e lëna gjatë vitit 2025 janë audituar gjatë muajit Mars 2026 dhe është hartuar raport i veçantë për realizimin dhe ecurinë e zbatimit të tyre. Ndërkohë që në të gjitha angazhimet e auditimit është vlerësuar dhe audituar zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm si çështje e veçantë, duke vlerësuar statusin e tyre.

## V. AUDITIMI I JASHTËM

**Gjatë vitit 2025 bashkia është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas shkresave më poshtë:**

☛ Shkresa nr.510/5 prot.datë 30.04.2025 “Njoftim për fillim Projekt Auditimi”;Auditim Tematik me object “Auditim i procedurave të dhënies së lejeve ,liçensave dhe monitorimin për aktivitetin minerar ,me vendndodhje në Rasek,Shkodër”.

☛ Shkresa nr. 17896/58 Prot .datë 24.06.2025 është dërguar Raporti Përfundimtar i auditimit “Auditim financiar Perputhshmërie Bashkia Shkodër, periudha e auditimit 01.01.2023-31.12.2023”.

☛ Shkresa nr.684/7 Prot.datë 01.08.2025 ,Projekt Raport i zbatimit të rekomandimeve për Auditimin e Performancës me temë “Respektimi i Standarteve në menaxhimin e mbetjeve urbane ,sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullësisë”.

☛ Shkresa nr.12196 datë 04.08.2025 Projekt Raport Auditimi “Dërgohet Raporti Përfundimtar Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në tregun e punës” .

☛ Shkresa nr.510/20 Prot.datë 08.08.2025 “Projekt Raport Auditimi për auditimin tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ,Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ,Agjencinë Kombëtare të Mjedisit,Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore ,Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit ,Bashkinë Shkodër”

☛ Shkresa nr 122/25 Prot. datë 22.09.2025” Dërgohet Raporti Përfundimtar “Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar”.

☛ Shkresa nr.630/42 prot. datë 30.09.2025 Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e performancës me temë “Cilësia e ujërave në plazhe”.

☛ Shkresa nr.510/32 prot.datë 09.12.2025 “Raport Përfundimtar Auditimi, Auditim tematik “Për auditimin e procedurave të dhënies së lejeve ,liçensave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në RASEK ,Shkodër”.

## **VI. MASAT E MARRA GJATË VITIT PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË NJËSI DHE PLAN VEPRIMI PËR TË ARDHMEN**

- ✿ Zhvillimi i planifikimit strategjik, sidomos në kuadër të koordinimit të planifikimit strategjik dhe atij operacional, lidhjes së objektivave strategjike dhe programeve, si dhe të parashikimit të fondeve të nevojshme financiare për implementimin e tyre.
- ✿ Zhvillimin i konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe krijimi i parakushteve me qëllim përcaktimin e autoriteteve dhe përgjegjëseve të qarta për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore në mënyrë objektive.
- ✿ Zhvillimi dhe përmirësimi i mekanizmave të kontrollit, veçanërisht në proceset e ciklit të buxhetit, duke përfshirë proceset e planifikimit, programimit, dhe ekzekutimit të planeve financiare, si dhe në procesin e prokurimit dhe kontraktimit, duke theksuar kryesisht zhvillimin e kontrolleve ex-ante (për shembull: kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të ndikimit të projekteve të propozuara mbi fondet publike, apo përcaktimin e kriterëve të qarta për alokimin e fondeve, etj) dhe kontrolleve ex-post (si kontrolle në vend, etj.).
- ✿ Kryerja e vetëvlerësimit periodik të sistemit të kontrollit të brendshëm nga ana e nivelit të lartë menaxherial të njësisë publike, për identifikimin e mangësive të mundshme dhe zbatimin e kontrolleve më efektive.
- ✿ Realizimi i programeve të trajnimeve gjithëpërfshirëse për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumentave të kontrollit të brendshëm.
- ✿ Hartimi dhe miratimi nga ana e njësisë publike të procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.
- ✿ Hartimi i planeve operationale të konsoliduara të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- ✿ Përdorimi i mundësisë së delegimit si një element i rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe realizimin me efektivitet të funksioneve të nivelit të lartë menaxherial.

- ✿ Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.
- ✿ Përfshirja në takimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

## **VII. REKOMANDIME TE PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDESHËM**

Për të siguruar përmbushjen e objektivave të institucionit të Bashkisë Shkodër për një menaxhim sa më efektiv të burimeve publike dhe pas analizës së bërë në kuadër të kontrollit të brendshëm:

### ***Rekomandojmë :***

- ✿ Vlerësimin e mundësisë së riskut për mashtrime dhe kryerjen e vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve nga ana e njësisë publike, në mënyrë që vlerësimi i riskut të mashtrimit të bëhet pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut.
- ✿ Rritjen e ndërgjegjësimit të njësisë publike në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e korrupsionit dhe mashtrimit, në rastet e shkeljeve të sinjalizuara.
- ✿ Ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.
- ✿ Kryerjen e procedurave standarde të veprimit sipas drejtorive, sektorëve, njësisve, etj.
- ✿ Në kuadër të përmirësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të rritjes së transparencës të përdorimit të fondeve të bashkisë Shkodër, si dhe për një menaxhim sa më ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare, është e nevojshme instalimi i sistemit financiar. Lidhur me sistemet e kontabilitetit, njësia publike duhet të ketë një program të unifikuar si dhe parashikimi për përmirësime të mëtejshme në sistemin e kontabilitetit.
- ✿ Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.
- ✿ Angazhimin e audituesve të brendshëm në vlerësimin e proceseve të vendimmarrjes, vendimeve strategjike dhe operationale, mbikëqyrjen e menaxhimit të riskut, promovimin

e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda organizatës, sigurimin e menaxhimit efektiv organizativ të performancës dhe llogaridhënies.

- ✿ Angazhimin e audituesve të brendshëm në vlerësimin e risqeve më të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e projekteve dhe programeve për arritjen e objektivave strategjike të njësive publike.
- ✿ Monitorimin në vazhdimësi nga njësitë e auditimit të brendshëm i nivelit të zbatimit dhe cilësinë e rekomandimeve të dhëna, me qëllim që realizimi i shërbimit të auditimit të shihet si vlerë e shtuar nga titullari e njësisë publike dhe të gjithë grupet e interesit.
- ✿ Bashkëpunimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të menaxhuar programe sa më cilësore të trajnimit të vijueshëm profesional duke përfshirë në program tema që zhvillojnë kapacitetet profesionale të audituesve të brendshëm
- ✿ Miratimin e regjistrit të riskut të konsoliduar nga Nëpunësi Autorizues dhe të hartimin e instrumentave për menaxhimin e riskut sipas përcaktimeve rregullative të fushës, hartimi i urdhërit të Grupit të Menaxhimit të Riskut ,strategjia e menaxhimit të riskut (plani i menaxhimit të riskut), dhe plani i veprimit për minimizimin e risqeve , për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre. Gjatë takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik të trajtohen problematika që lidhen me MFK-në duke e shtrirë fokusin në vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi
- ✿ Përditësimin e rregulloreve të brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të njësisë publike dhe me bazën rregullatore të kontrollit të brendshëm.
- ✿ Në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe procedurave ekzistuese të punës, ndërtimin e hartave dhe manualeve të proceseve të punës dhe konsolidimin në një dokument të vetëm.
- ✿ Hartimin e planit vjetor të punës të konsoliduar për të gjithë institucionin duke përcaktuar qartë linjën e raportimit.

## VIII. SPONSORIZIMET PER VITIN 2025

Për vitin 2025 Bashkia Shkodër ka marre sponsorizime ne natyre në shumën **18,766,135 lek** si më poshtë vijon:

Nr	Pershkrimi	Vlera
1	Ministria e Brendshme(Drejtoria e pergjithshme e Gjendjes Civile , Çertifikata )	90,708
2	Ministria Brendshme(Drejtoria e pergjithshme e Gjendjes Civile , boje )	48,215
3	World Vision Albania(Dhurim paisje zyre )	19
4	KORADO(Dhurim paisje celular )	29,900
5	Organizata nderkombetare per emigracionin IOM(Dhurim paisje informatike )	282,929
6	IOM OFFICE (Dhurim paisje zyre )	109,200
7	Melgushi shpk(Dhurim paisje )	25,572
8	Keshilli i Qarkut(Dhurim pjese elektrike)	3,123,312
9	GIZ ALBANIA (Dhurim Automjet Traktor SD 804)	3,307,080
10	Agjensia Kombetare e Zonave te Mbrojtura (dhurim Varke per pastrimi liqenesh Havester H650)	11,749,200
		<b>18,766,135</b>

**Benet BECE**  
Nëpunësi Autorizues  
**KRYETAR I BASHKISË SHKODËR**



Zv. Kryetar



Zv. Kryetar



Zv. Kryetar




Drejtoria e Përgjithshme Menaxhimit  
Financiar



Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit  
të Qëndrueshëm Ekonomik




Drejtoria e Përgjithshme Juridike,  
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve  
Mbështetëse




Drejtoria e përgjithshme e  
Planifikimit dhe Zhvillimit të  
Territorit



Drejtoria e Përgjithshme Sociale dhe  
Rinisë



Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës  
dhe Sportit



Drejtoria e Taksave dhe Tarifave  
Vendore

Drejtoria e Analizës dhe  
e Programimit Buxhetor





Drejtoria e Financës




Drejtoria e Sportit



Drejtoria Juridike

Drejtoria e Arsimit



Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit  
të Territorit

Drejtoria e Ndihtmes Ekonomike dhe të personave me aftësi ndryshe

Edon Çeliku

Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme

Adela Shllata Alcu

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Arbete Zerej

Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, menaxhimit të ZIN, projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

Jon

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP

Skol

Drejtoria e Turizmit

Renat Dumçi

Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane

VALDO DIBRA

Drejtoria e Emergjencave Civile

Xhelmet Dani

D/ Anisi Ocu

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë Strehimit dhe Shëndetit Publik

A. Kneja

Drejtoria e Kulturës

Sara Smajaj

Drejtoria e Policisë

SAIMIR KRISTANI

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Khardhina

Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit

ICONIS DRAGANI

Njësia e Prokurimeve

Lente Dilaveri Juseliti

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi

Agim Pami

N.Z.

Geza Gjyshi

Inspektoriati Mbrojtjes së Territorit

Spelin Forri

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike

Artur Pollo

N.Z.

Suzana Sarajci

Administrimi dhe Inspektimi i Pyjeve

Arbëra Tyle

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

Gloria Kulla

N.Z.

Gilbert Marbu

Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç Shkodër

Viktorina Gazelli

N.Z.

FAUSTA DENA

Qendra e Zhvillimit

Freduola Dena

N.Z.

Freduola Dena

Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç Shkodër

Luigjet Radevci

N.Z.

Luigjet Radevci